

Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje

(Janar-qershor 2023)



TITULLI:

Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje (Janar-qershor 2023)

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

Shtator, 2023

PUBLIKUAR NGA:

Lëvizja FOL

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

1.

JANAR - QERSHOR 2023

Performanca e prokurorisë në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje

Rezultatet nga përlogaritja e performancës së organeve të sistemit të drejtësisë së Republikës së Kosovës në trajtimin e lëndëve të dhunës në familje, si ndër problemet më të mëdha me të cilat po përballet shoqëria kosovare dhe aparati shtetëror, janë tregues mbi seriozitetin, vullnetin dhe vendosmërinë e sistemit të drejtësisë në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurive.

Në vijim janë paraqitur indikatorët matës të efikasitetit të punës së Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje në gjashtë - mujin e parë të vitit 2023. Ndërsa pasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit prokurorial, në të cilët janë bazuar këta indikatorë, është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Këto statistika janë bazuar në të dhënat zyrtare të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



TABELA 1. Rastet e lëndëve të dhunës në familje në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2023).

1.1 Fluksi i lëndëve

Fluksi i lëndëve është tregues bazë i ngarkesës dhe barrës me punë të sistemit dhe përfshin lëndët e reja të krijuara gjatë vitit dhe lëndët e trashëguara nga periudhat para-prake.

Shtatë prokuroritë themelore gjatë gjashtë - mujorit të parë të vitit 2023 kanë pasur në punë gjithsej 2,7890 raste të dhunës në familje, 1,519 lëndë prej të cilave kanë qenë të trashëguara nga periudhat para-prake, ndërsa 1,371 lëndë të reja të krijuara gjatë kësaj periudhe.



VEPRA PENALE



Gjithsej lëndë
në punë

=



Lëndë të
trashëguara

+



Lëndë të
reja

DHUNË NË FAMILJE

2890

1371

1519

TABELA 2. Fluksi i lëndëve të dhunës në familje në Prokurorin e Shtetit (1 janar -30 qershor 2023).

1.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që tregon performancën e sistemit në zgjidhjen e lëndëve përkatëse, të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të sistemit.

Pra në kuadër të matjes në këtë indikator nuk përfshihen numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak. Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një prokurorie të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të sistemit në zgjidhjen e lëndëve të reja.

Norma ideale e zgjidhjes së lëndëve do të duhej të ishte 100%, që nënkupton se sistemi zgjidh aq lëndë sa pranon gjatë vitit.

Sipas tabelës së mëposhtme, norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2023 në shtatë prokuroritë themelore dhe në Prokurorinë Speciale rezultoi të jetë 116%.

VEPRA PENALE	$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$
DHUNË NË FAMILJE	$\frac{1770}{1519} \times 100 = 117\%$

TABELA 3. Norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2023).

1.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi prokurorial ose prokuroria e zëvendëson numrin e lëndëve të reja.

Me fjalë të tjera, norma e qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjedhjen e një lënde.

Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm.

Sipas tabelës së mëposhtme, norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në gjashtë - mujorin e parë të vitit 2023 në shtatë prokuroritë themelore rezulton të jetë 1.29.

VEPRA PENALE

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët pa zgjidhura (PE)}}$$

DHUNË NË FAMILJE

$$\frac{1770}{1371} = 1.29$$

TABELA 4. Norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në Prokurorin e Shtetit (1 janar - 30 qershor 2023).

1.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve të cilat kishin mbetur të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe.

Pra numri 181 është numri i ditëve të gjashtë- mujorit të parë të vitit 2023, që pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve që ka rezultuar gjatë kësaj periudhe në Institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Nga tabela e mëposhtme shihet se, nëse vazhdohet me këtë trend të zgjidhjes së lëndëve, Prokurorit të Shtetit i duhen 140 ditë për të zgjidhur lëndët e dhunës në familje.


VEPRA PENALE	Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	$= \frac{181}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$
DHUNË NË FAMILJE	$\frac{181}{1.29} = 140$	

TABELA 5. Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në Prokurorin e Shtetit (1 janar -30 qershor 2023).

1.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

Ashtu siç shihet në tabelën e mëposhtme, në vitin 2023 në Prokurorin e Shtetit janë bartur gjithsej 1371 lëndë të dhunës në familje nga viti paraprak.

VEPRA PENALE	Indeksi i lëndëve të grumbulluara = $\frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$
DHUNË NË FAMILJE	$\frac{1371}{770} = 1.78$

TABELA 6.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara të dhunës në familje në Prokurorin e Shtetit (1 janar -30 qershor 2023).

2.

Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje

Në vijim janë paraqitur indikatorët matës të efikasitetit të punës së shkallës së parë të sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2023. Ndërsa pasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit gjyqësor për këtë gjashtë-mujor,

në të cilët janë bazuar këta indikatorë, është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Këto statistika janë bazuar në të dhënat zyrtare të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.




TABELA 7. Rastet e lëndëve të dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2023).

2.1 Fluksi i lëndëve

Fluksi i lëndëve është tregues bazë i ngarkesës në punë dhe përfshin lëndët e reja dhe lëndët e trashëguara.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, shkalla e parë e sistemit gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës janar-

qershor 2023 ka pasur gjithsej 2,918 lëndë të dhunës në familje në punë, ku 2,195 lëndë kanë qenë të trashëguara nga periudhat paraprake, ndërsa 723 lëndë kanë qenë të reja të krijuara gatë vitit.



Gjykatat e Republikës
së Kosovës



Gjithsej lëndë
në punë

=



Lëndë të
trashëguara

+



Lëndë të
reja

- DHUNE NE FAMILJE

2918

2195

723

TABELA 8. Fluksi i lëndëve të dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2023).

2.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në gjashtë - mujorin e parë të vitit 2023 në shtatë gjykatat themelore rezulton të jetë 124%.

**GJYKATAT E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

DHUNË NË FAMILJE

$$\frac{900}{723} \times 100 = \mathbf{124\%}$$



TABELA 9. Norma e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2023).

2.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Sipas tabelës së mëposhtme, norma e qarkullimit të vitit 2023 në shtatë gjykatat themelore rezulton të lëndëve të dhunës në familje në gjashtë - mujorin e parë jetë 0.41.

GJYKATAT E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e pazgjidhura (PE)}}$$

DHUNË NË FAMILJE

$$\frac{900}{2195} = 0.41$$



TABELA 10. Norma e qarkullimit të lëndëve të dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2023).

2.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Sipas rezultateve të matjes së këtij indikator, nëse gjykatave themelore u duhen mesatarisht edhe 446 ditë vazhdohet me trendin e njëjtë të zgjidhjes së lëndëve, për zgjidhjen e lëndëve të dhunës në familje.

$$\text{VEPRA PENALE} \quad \text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{181}{\text{norma e çarkullimit të lëndëve}}$$

$$\text{DHUNË NË FAMILJE} \quad \frac{181}{0.41} = 441$$

TABELA 11. Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2023).

2.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Sipas rezultateve të këtij indikatori të paraqitura në tabelën e mëposhtme, indeksi i lëndëve të grumbulluara të dhunës në familje gjatë këtij gjashtë-mujori rezulton të jetë 3.13.

$$\text{VEPRA PENALE} \quad \text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$

$$\text{DHUNË NË FAMILJE} \quad \frac{2195}{700} = 3.13$$

TABELA 12. Indeksi i lëndëve të grumbulluara të dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor (1 janar - 30 qershor 2023).

3. Shtojcë

Nga matja e përgjithshme e të dhënave statistikore të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës për lëndët e dhunës në familje në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2023 të projektuar

përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për matjen e Efikasitetit të Drejtësisë, rezultojnë të dhënat nga tabela e mëposhtme.

TABELA 13.

Rezultatet nga indikatorët matës të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë për lëndët e dhunës në familje në shkallën e parë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial (1 janar - 30 qershor 2023).



Sistemi prokurorial



Sistemi gjyqësor

INDIKATORËT PËR MATJEN
E EFIKASITETIT TË
DREJTËSISË (CEPEJ)

Norma e zgjidhjes
së lëndëve

117%

124%

Norma e qarkullimit
të lëndëve

1.29

0.41

Kohëzgjatja e zgjidhjes
së lëndëve

140

441

Indeksi i lëndëve
të grumbulluara

1.78

3.13

FOL

